

LIGJ
Nr.7540, datë 17.12.1991

PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN E FAMILJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Nenet 1 dhe 2 të Kodit të Familjes, shfuqizohen.

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si vijon:

"Legjislacioni i familjes bazohet në dispozitat kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Familja bazohet në marrëdhëniet që lindin nga martesë, gjinia dhe birësimi. Ajo mbështetet në ndjenjën e dashurisë dhe të respektit ndërmjet anëtarëve të saj. Familja ka për detyrë t'i edukojë fëmijët me ndjenjën e dashurisë për atdheun dhe kombin shqiptar".

Neni 4

Paragrafi i dytë i nenit 5, shfuqizohet.

Neni 5

Neni 6 ndryshohet si vijon:

"Anëtarët e familjes kanë të drejta dhe detyrime të barabarta në familje. Gruaja gëzon të drejta të barabarta me burrin".

Neni 6

Neni 7 ndryshohet si vijon:

"Prindërit përgjigjen për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre".

Neni 7

Neni 95 ndryshohet si vijon:

"Në vendimin e zgjidhjes së martesës gjykata duhet të përmendë shkaqet e zgjidhjes së martesës dhe, kur është rasti, të përcaktojë edhe fajësinë e bashkëshortit që bëhet shkaktar për zgjidhjen e saj, kur kërkohet nga palët".

Neni 8

Neni 104 ndryshohet si më poshtë:

"Detyrat e kujdestarisë kryhen nga këshilli i kujdestarisë që krijohet në çdo komitet ekzekutiv

të rrethit dhe të rajonit. Ai kryesohet nga një anëtar i këtij komiteti dhe ka në përbërje arsimtarë, mjekë, juristë dhe drejtues të organizatave shoqërore e bamirëse të rrethit, etj."

Përbërja e këshillit të kujdestarisë caktohet në çdo tre vjet me vendim të komitetit ekzekutiv të rrethit a të rajonit.

Këshilli i kujdestarisë ndihmohet në veprimtarinë e tij nga organet e pushtetit dhe nga organizatat shoqërore bamirëse".

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.101, datë 25.12.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.